



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e hënë, në datën 18 janar 2021, në mjediset e AMA-s, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar

AMA pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Dhënien e licencës për transmetime audio analoge, shoqërisë “I.B.C- TELECOM” sh.p.k., për subjektin audio “Radio I.B.C” për të mbuluar me sinjal audio “*Bashkitë Shkodër dhe Vau i Dejës*”. **(Vendimi nr. 3, datë 18.01.2021)**
2. Zëvendësimin e licencës për transmetime analoge me licencë shërbimi programi audioviziv të shoqërisë “Channel 7” sh.p.k., për subjektin audioviziv “TV Channel 7”, për të ofruar shërbim në qarkun Gjirokastrë. **(Vendimi nr. 4, datë 18.01.2021)**
3. Zëvendësimin e licencës për transmetime analoge me licencë shërbimi programi audioviziv të shoqërisë “AMG 2000” sh.p.k., për subjektin audioviziv “TV Alpo”, për të ofruar shërbim në qarkun Gjirokastrë. **(Vendimi nr. 5, datë 18.01.2021)**
4. Konstatimin e pavlefshmërisë së licencës të shoqërisë “Best Channel” sh.p.k., për transmetime televizive analoge për subjektin “Best Channel”. **(Vendimi nr. 6, datë 18.01.2021)**
5. Konstatimin e pavlefshmërisë së licencës të shoqërisë “Tv Skampa” sh.p.k., për transmetime televizive analoge për subjektin “TV Skampa”. **(Vendimi nr. 7, datë 18.01.2021)**
6. Pranimin e ankimit administrativ të shoqërisë “Channel 7” sh.p.k., dhe shfuqizimin e sanksionit gjobë nr. 6, datë 23.12.2020, në masën 120.000 lekë, vendosur ndaj subjektit audioviziv privat vendor “Tv Channel 7”. **(Vendimi nr. 8, datë 18.01.2021)**

AMA në këtë mbledhje mori në shqyrtim relacionet dhe projektvendimet:

- “Për heqjen/konstatimin e pavlefshmërisë së licencës/autorizimit të subjekteve debitorë ndaj AMA-s dhe/ose Buxhetit të Shtetit për vitin 2020” dhe
- “Për mosrinovimin e licencës të shoqërisë “Intel Media” sh.p.k., për subjektin audio privat “Radio Jug”, dhe ra dakord t’u caktojë këtyre subjekteve afat deri në mbledhjen e radhës për përmbushjen e detyrimeve financiare.

Gjatë zhvillimit të mbledhjes, 3 anëtarë të AMA-s e ndërprejnë mbledhjen dhe projektvendimi “Për ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Channel One” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat “TV Ora News”, për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm ligjor për vijimin e mbledhjes së AMA-s (4 anëtarë), shtyhet për në mbledhjen e radhës.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 18 janar 2021